



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
REKTORATI

Nr. 1700/6 Prot.

Vlorë, më, 25.11.2021

**VENDIM**

**Nr. 28, datë 04. 11. 2021**

**PËR**

**MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË LËNA PREJ BORDIT TË AKREDITIMIT PËR AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË FINANCË.**

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17. 09. 2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe Programeve të Studimit, në vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 22, datë 19. 02. 2021 “Për Akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë bachelor në Financë, të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, si dhe me Vendimin e Rektoratit Nr. 19 Prot, datë 30. 10. 2020, faza e tretë, pika 2, në mbledhjen e zhvilluar në datën 04.11.2021, Rektorati

**VENDOSI**

Të miratojë Planin e Veprimit për përmbushjen e rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit për akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë.

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi fakultetet, departamentet, Zv. Rektori Akademik, Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, Departamenti i Kontabilitet-Financë, administrator i UV-së, Drejtoria e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve dhe strukturat e tjera mbështetëse të UV-së.
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Një kopje e këtij vendimi i përcillet ASCAL

**REKTORI**  
**Prof.Dr. Roland ZISI**

